



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, 23 dhjetor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Qamile Morina, Nurishahe Hulaj, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi, Teuta Hadri dhe Gjylnaze Sylja.

Mungoi: Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënesisë Nr. 02/L-73;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënësisë Nr. 02/L-73

Teuta Hadri – raportuese – Tha se grupi i punës i ka pasur dy takime me zyrtarë të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe ka arritur në përfundim se neni 16, pika 1.2, duhet të amendamentohet, sepse është në kundërshtim me Kodin e përkohshëm penal të Kosovës. Kjo pikë amendamentohet si vijon:

Amendamenti 1

Të hiqet pika 1.2 e nenit 16

Armend Zemaj – Tha se grupi i punës është pajtuar që të amendamentohet neni 16, pika 1.2, sepse po të mbetë ky nen, ashtu siç është miratuar në Kuvend, atëherë duhet të fillohet procedura e amendamentimit të KPPK-së dhe e Ligjit për shëndetësi. Propozoi të miratohet propozimamendamenti i grupit të punës.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi propozimamendamentin e grupit të punës.

4. Të ndryshme

Qamile Morina – Tha se raporti me rekomandime u është dorëzuar anëtarëve të Komisionit dhe pret nga ata që në këtë mbledhje të vendosin a e përkrahin apo jo propozimin për organizimin e dëgjimit publik. Grupi i punës për monitorimin e Ligjit fillimisht është pajtuar të mbahet një dëgjim publik, por më vonë ky mendim u ndryshua. Nëse Komisioni vendos të mos mbahet dëgjimi publik, atëherë propozoj që grupi i punës përsëri ta vizitojë Ministrinë e Shëndetësisë.

Ajo tha se nuk ka propozuar ndryshime në udhëzime administrative. Përfaqësuesit e institucioneve të vizituara kanë pasur propozime konkrete për ndryshimin e disa neneve të udhëzimeve administrative. Në organizimin e dëgjimeve publike do të kërkojmë paraprakisht nga të ftuarit që vërejtjet dhe propozimet konkrete t'i dorëzojnë me shkrim.

Mimoza Ahmetaj – Lidhur me propozimin e organizimit të dëgjimit publik tha se Komisioni është deklaruar kundër këtij propozimi. Sa i përket raportit për monitorimin e Ligjit, në të cilin parashihet se “*kërkesa për revidimin e udhëzimeve administrative mbetet pas dëgjimit publik*”, kjo pjesë nuk duhet të mbetet në këtë raport, sepse Komisioni është deklaruar kundër organizimit të dëgjimit publik.

Asnjëri nga përfaqësuesit e institucioneve të vizituara nuk ka ditur të na tregojë, se cili nga nenet është problematik dhe a duhet të ndryshohet. Asnjëra nga institucionet e vizituara nuk ka pasur vërejtje sa i përket ligjit.

Teuta Hadri – Tha se është kundër organizimit të dëgjimit publik, sepse anëtarët e këtij komisioni kanë njohuri më të hollësishme për zbatimin e këtij ligji dhe nuk e besoj që ky komision do të mund të marrë informata nga qytetarët sa po zbatohet ky ligj.

Propozoi që Komisioni në vitin 2009 energjinë e vet ta orientojë në Ligjin për sigurime shëndetësore dhe në Ligjin për pensione.

Nurishahe Hulaj – Tha se grupi i punës është dashur të vendoste për ta mbajtur ose jo dëgjimin publik, ndërsa Komisioni duhet ta përkrahë atë që e konsideron të nevojshëm ky grup.

Rita Hajzeraj - Në mbledhjen e kaluar është votuar për këtë propozim. Nga votimi rezulton se asnjëri nga anëtarët nuk ka qenë kundër dëgjimit publik. Duhet të miratohet propozimi për organizimin e një dëgjimi publik, sepse pjesëmarrës do të jenë edhe shumë institucione që grupi i punës nuk ka arritur t'i vizitojë. Me 10% të vizitave nuk mund ta kemi një raport gjithëpërfshirës për zbatimin e këtij ligji.

Armend Zemaj – Tha se më të arsyeshëm e sheh propozimin për vizitën në Ministrinë e Shëndetësisë, se organizimin e dëgjimit publik, sepse gjendja atje ka ndryshuar. Secili nga anëtarët e grupit të punës duhet të sjellë rekomandime, pastaj të plotësohet raporti. Në fund duhet të konstatojmë se a është raporti i mangët dhe a ka nevojë për organizimin e dëgjimit publik. Monitorimi i Ligjit ka të bëjë me zbatimin e tij, pavarësisht nëse Ligji është i mirë ose i keq. Çështja e nismës së procedurës për ndryshimin e këtij ligji, është çështje që duhet merret ndaras nga ajo e monitorimit të këtij ligji.

Gjylnaze Sylja – Dëgjimet publike janë pjesë e punës së Komisionit. Raporti për monitorimin e Ligjit duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës. Ministria e Shëndetësisë, deri tani, është sjellë si ministri e sektorit publik, jo edhe si e sektorit privat. Komisionit i duhen informatat që do të mund të merreshin në dëgjimin publik. Këto informata duhet të merren nga të dy anët, informatën nuk e bëjmë ne, sepse njerëzit janë ata që na japin informata. Propozoj të përkrahet propozimi për organizimin e dëgjimit publik. Ajo mendon se udhëzimet administrative kanë nevojë të ndryshohen, jo Ligji. Sipas rregullores Qeveria duhet ta përgatisë raportin vjetor për zbatimin e ligjeve.

Sadik Idriz – Organizimi i dëgjimit publik dhe rekomandimet nuk nënkuptojnë që Komisioni e ka filluar procedurën për ndryshimin e Ligjit. Mangësia më madhe e Kuvendit të Kosovës është se nuk ka nisma nga grupet parlamentare, as nga deputetët, për amendamentimin e Ligjit. Aktualisht ne jemi duke e bërë monitorimin e Ligjit dhe nëse Komisioni konstaton se Ligji ka mangësi, atëherë Komisioni do të fillojë procedurë tjetër për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit. Nëse Komisioni konstaton se udhëzimet administrative paraqesin problem për zbatimin e tij, atëherë Komisioni do t'i rekomandojë Ministrisë të ndryshohen ato udhëzime. Personalisht e përkrah propozimin për organizimin e dëgjimit publik.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit ta votojnë propozimin për organizimin e një dëgjimi publik në kuadër të monitorimit të Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi.

*Kryesuesi konstatoi se me **pesë vota për dhe tre kundër** u miratua propozimi për organizimin e dëgjimit publik.*

Dëgjimi publik do të organizohet në sesionin pranveror.

Mbledhja përfundoi në orën 11:44

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz